Me pistoletë më vete prezantohej si efektiv policie dhe futej në institucione, arrestohet 40-vjeçari në Tiranë, i zbulohet "arsenal" municionesh në banesë

30 Janar, 2023 11:16



Madhësia e tekstit:

Forcat "Shqiponja" kanë arrestuar ditën e sotme një 40-vjeçar në Tiranë, i cili përmes një dokumenti fals prezantohej si efektiv policie, duke e përdorur këtë edhe për t'u futur në institucione.

Në momentin e arrestimit atij i është sekuestruar edhe një armë zjarri me fishekë në gojë, ndërsa 40-vjeçarit iu gjetën në banesë, municion luftarak, pranga, dokumente të falsifikuara për autorizim hyrjeje në institucione, mbajtëse arme dhe maskë si ato të Policisë.

"Shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Nr. 3, në vijim të punës për evidentimin dhe gjetjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e siguruara përmes inteligjencës informative për një shtetas që prezantohej si punonjës i forcave speciale të Policisë, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Special".

Gjatë operacionit, në rrugën "Hamid Shijaku", shërbimet e Policisë kanë lokalizuar dhe ndaluar shtetasin K. Gj., të cilit, gjatë kontrollit fizik, i kanë gjetur një armë zjarri pistoletë me fishek në fole gati për qitje dhe një krehër me municion luftarak.

Në vijim të veprimeve, gjatë kontrollit të banesës së këtij shtetasi, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale municion luftarak, një palë pranga, dy dokumente të falsifikuara për autorizim hyrjeje në institucione, një mbajtëse arme dhe një maskë si ato të Policisë.

Në përfundim të veprimeve u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit K. Gj., 40 vjeç, banues në Tiranë dhe materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale 'Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit', 'Mbajtja pa të drejtë e uniformës', dhe 'Falsifikimi i dokumentev'", bën me dije policia.

Për t'u bërë pjesë e grupit 'Balkanweb' mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: arme falsifikim polic policia

TË NGJASHME

Kontrolle në një javë nga policia/ Pa patentë dhe të dehur në timon, 18 shoferë të arrestuar në Tiranë
30 Janar, 2023

I mori lajen e qarkullimit dhe i vuri gjobë, 48-vjeçari grushton efektivin e policisë, arrestohet
29 Janar, 2023

Taboola Feed

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
Play for free. No Install.
GrandSavings | Sponsored

Belly Fat Removal Without Surgery in Albania: The Price Might Surprise You
Belly Fat Removal | Search Ads | Sponsored

Historia e birësimit të Blendi Fevziut. Ja cilët ishin prindërit e gazetarit
Historia e birësimit të Blendi Fevziut. Ja cilët ishin prindërit e gazetarit
balkanweb.com


You will never turn off your computer again. No Install. Play for free.
GrandSavings | Sponsored

TË FUNDIT NGA KRONIKË

"Big Brother" edhe në Tiranë/ Çmontohen 11 kamera, 5 prej tyre të vendosur në banesën e një të dënuari për vrasje
30 Janar, 2023

(EMIRAT) Me shpejtësi të lartë dhe në gjendje të dehur, aksidentohet çifti shqiptar, humb jetën 23-vjeçarja shtatzënë
30 Janar, 2023

"Vëllai ishte rrëfyuar në ballkon dhe kishte vdekur, edhe gruaja ime.." i moshuari befason nga gjykata: S'kam vrarë njeri!
30 Janar, 2023

Krimi horror në Gramsh/ Vrau gruan dhe vëllanë me sëpatë, i moshuari shfaqet i qetë brenda kafazit të shamit, lihet në burg
30 Janar, 2023

Ish-ministri i Financave, Shkëlqim Cani shkon në SPAK. Do të japë dëshmi për...
30 Janar, 2023

Ishte fshehur në kamion, sekuestrohen mbi 100 kg marijuanë në Kosovë
30 Janar, 2023

KATEGORIA VIDEO

Me pistoletë më vete prezantohej si efektiv policie dhe futej në institucione, arrestohet 40-vjeçari në Tiranë, i zbulohet "arsenal" municionesh në banesë
30 Janar, 2023

Projekti "Durrës Yacht & Marina"/ Rama: Transformim rrënjësor për vijën bregdetare, më shumë cilësi dhe vende punë
30 Janar, 2023

"Vëllai ishte rrëfyuar në ballkon dhe kishte vdekur, edhe gruaja ime.." i moshuari befason nga gjykata: S'kam vrarë njeri!
30 Janar, 2023

Krimi horror në Gramsh/ Vrau gruan dhe vëllanë me sëpatë, i moshuari shfaqet i qetë brenda kafazit të shamit, lihet në burg
30 Janar, 2023

Pas përfundimit të reshjeve përmirësohet situata në Shkodër, ja sa është sipërfaqja e përmbytjeve
30 Janar, 2023

"Mos bini pre e propagandës"/ Këlliçi takohet me banorët në Tiranë: Në 14 maj fitorja e padiskutuar!
30 Janar, 2023

Download on the App Store GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Bucks synojnë kreun në Lindje, Memphis rikthehet te fitorja pas 5 humbjeve
30 Janar, 2023

"Big Brother" edhe në Tiranë/ Çmontohen 11 kamera, 5 prej tyre të vendosur në banesën e një të dënuari për vrasje
30 Janar, 2023

Projekti "Durrës Yacht & Marina"/ Rama: Transformim rrënjësor për vijën bregdetare, më shumë cilësi dhe vende punë
30 Janar, 2023

Rusia me strategji të qartë për të motivuar forcat ushtarake në luftën kundër Ukrainës, premton shpërblim për çdo...
30 Janar, 2023

Kërcënohet në shtëpi, ultrasit roman kalojnë limitet, terrorizohet Zaniolo
30 Janar, 2023

Zbulohet skenari i PS për të shmangur bllokimin e seancave të Kuvendit nga PD: Nëse opozita zapton folloren...
30 Janar, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.